**VENDIM**
**Nr. 306, datë 11.5.2022**

# PËR PROCEDURAT QË NDIQEN PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE ARTISTIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 26, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e procedurës për financimin e projekteve artistike në fushën e artit pamor, si dhe shpalljen e konkurseve kombëtare dhe/ose ndërkombëtare për realizimin e tyre në hapësira publike, në zbatim të parashikimit të dhënë në shkronjën "b", të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", të ndryshuar.

2. Projektet artistike, të financuara sipas procedurave të parashikuara në përmbajtje të këtij vendimi, realizohen në përputhje me parametrat e veprës së artit dhe hapësirat publike.

3. Rast pas rasti, ministri përgjegjës për artin dhe kulturën mund të urdhërojë ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, i cili përcakton parametrat e veprës së artit dhe hapësirat publike për vendosjen e tyre.

II. PROCEDURAT E ORGANIZIMIT TË KONKURRIMIT PUBLIK KOMBËTAR OSE NDËRKOMBËTAR PËR FINANCIMIN E PROJEKTEVE ARTISTIKE

1. Me propozim të Kolegjiumit, ministri përgjegjës për artin dhe kulturën miraton urdhrin për shpalljen e konkursit kombëtar ose ndërkombëtar, i cili publikohet në medien kombëtare, kur konkursi është kombëtar dhe në medien ndërkombëtare për konkurset ndërkombëtare, si dhe në çdo rast në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën.

2. Urdhri për shpalljen e konkursit kombëtar ose ndërkombëtar përmban:

a) mënyrën dhe kohëzgjatjen e publikimit të njoftimit të konkursit kombëtar ose ndërkombëtar;

b) detyrën e projektimit, në të cilën pasqyrohen vendndodhja e hapësirës publike dhe përmasat e veprës artistike;

c) dokumentacionin që duhet të paraqesin artistët pjesëmarrës në konkurs;

ç) formatin e paraqitjes së projektidesë;

d) afatin e paraqitjes së projektidesë e të dokumentacionit dhe mënyrën e realizimit/prodhimit të veprës për ato projektide të cilat kualifikohen nga juria, sipas parashikimeve të fazës së parë të seleksionimit, në përputhje me përcaktimin e pikës 9 të këtij vendimi;

dh) vendin e dorëzimit të projektidesë dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit;

e) masën e shpërblimit për fituesin.

3. Artistët, me qëllim pjesëmarrjen në konkurs, dorëzojnë projektidenë dhe dokumentacionin e mëposhtëm në kohën dhe vendin e përcaktuar, sipas pikës 2 të këtij kreu:

a) Projektidenë ose bocetin e veprës artistike, si dhe materialet shoqëruese të tyre, sipas kërkesës së thirrjes për paraqitjen e idesë;

b) Portofolin e artistit, ku përfshihet jetëshkrimi i artistit, si dhe të paktën 2 foto profesionale të punimeve të ngjashme;

c) Llojin e materialit që parashikohet të përdoret për realizimin e veprës artistike.

4. Artistët, të cilët kualifikohen për të marrë pjesë në fazën e dytë të përzgjedhjes nga ana e jurisë, në zbatim të parashikimit të pikës 9 të këtij vendimi, dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm në vendin dhe kohën e përcaktuar sipas pikës 2 të këtij kreu, në lidhje me:

a) projektin inxhinierik ose arkitektonik për realizimin dhe ndërtimin e veprës, nëse ka të tillë;

b) përshkrimin e detajuar të fazave të realizimit të veprës artistike;

c) kohën dhe grafikun e realizimit të veprës, sipas periudhave kohore të parashikuara nga artisti;

ç) vlerën totale të veprës, të detajuar sipas preventivit, përfshirë shpërblimin për të drejtën e autorit mbi veprën artistike të krijuar;

d) vetëdeklarimin për angazhimin e artistit në realizimin dhe prodhimin/ndërtimin fizik të veprës artistike, deri në momentin e vendosjes së saj në hapësirën publike të miratuar;

dh) vetëdeklarimin e artistit për disponibilitetin e tij për punimet e mirëmbajtjes së veprës artistike për një afat 2-vjeçar nga momenti i vendosjes së saj në hapësirën publike të miratuar, në rast dëmtimi.

5. Me përfundimin e afatit për dorëzimin e projektideve nga artistët pjesëmarrës në konkurs në formën e paraqitjes sipas kërkesave të thirrjes, ministri përgjegjës për artin dhe kulturën miraton urdhrin për ngritjen e jurisë.

6. Juria përzgjedh listën e projektideve dhe të artistëve të kualifikuar për në fazën e dytë të seleksionimit, si dhe listën e projektideve më të mira, bazuar në vlerësimin artistik të veprës në raport me kërkesën, sipas renditjes përkatëse.

7. Juria përbëhet nga jo më pak se 5 personalitete të shquara kombëtare ose ndërkombëtare në fushën e artit e të kulturës, të cilët përzgjidhen nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën. Anëtarët e jurisë nuk duhet të kenë konflikt interesi me pjesëmarrësit në konkurs, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

8. Kolegjiumi harton listën e artistëve, të cilët kanë shprehur interesin në kohën dhe sipas formës së parashikuar në pikat 2 dhe 3, të këtij kreu, të cilën ia kalon për vlerësim jurisë. Artistët, të cilët nuk përmbushin këto kërkesa, nuk përfshihen në listë dhe konsiderohen se nuk kanë shprehur formalisht interesin e tyre.

9. Juria e konkursit vlerëson projektpropozimet dhe portofolat e artistëve të përfshirë në listën e artistëve, që kanë shprehur interes, duke hartuar listën e artistëve që kanë paraqitur projektidetë më të vlerësuara, të përzgjedhura për t'u kualifikuar në fazën e dytë të konkursit. Kjo listë i dorëzohet Kolegjiumit, i cili njofton artistët për të përmbushur kërkesat e parashikuara në pikën 4, të këtij kreu. Nga artistët, të cilët paraqesin dokumentacionin e parashikuar në pikën 4, juria rendit ata të cilët klasifikohen sipas vlerësimit artistik më të mirë të veprës.

10. Kolegjiumi, në zbatim të nenit 27/1, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar, përzgjedh me sistem pikëzimi fituesin e konkursit, bazuar në listën e përcjellë nga juria, sipas pikës 9, të këtij kreu. Metoda e sistemit të pikëzimit përcaktohet në urdhrin e ministrit që ngre Kolegjiumin.

11. Për vlerësimin me pikë të artistëve pjesëmarrës në konkurs, Kolegjiumi bazohet në kriteret e mëposhtme të vlerësimit:

a) Kapacitetet teknike të siguruara nëpërmjet marrëveshjes me subjekte që përfshijnë teknologji, hapësirën, mjetet në dispozicion për realizimin e projektidesë së dorëzuar, si dhe burimet njerëzore që disponojnë;

b) Çmimin më të ulët të ofruar në përpjesëtim me cilësinë e projektidesë;

c) Afatin e realizimit të veprës sipas grafikut të paraqitur, në përputhje me përcaktimin e shkronjës "c", të pikës 4, të këtij kreu.

12. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të kërkesave e propozimeve të dorëzuara, Kolegjiumi i propozon ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën klasifikimin përfundimtar të artistëve konkurrues me të cilët ministria përgjegjëse për artin lidh kontratën përkatëse.

13. Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën miraton projektin fitues, i cili publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e shpalljes së fituesit.

14. Njoftimi i publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike përmban:

a) emrin e fituesit të konkursit dhe adresën e tij;

b) afatin për nënshkrimin e kontratës.

15. Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën nënshkruan kontratën me fituesin e konkursit, e cila, ndër të tjera, përmban:

a) projektidenë e veprës dhe vendin e vendosjes së saj;

b) projektin e detajuar të realizimit të veprës, si dhe përshkrimin e detajuar të fazave të realizimit të veprës artistike fituese;

c) planin kohor të detajuar në afate për realizimin e veprës;

ç) detyrimin e fituesit të konkursit për ndjekjen e të gjitha fazave për prodhimin fizik të veprës deri në vendosjen e saj në hapësirën publike të miratuar për këtë qëllim;

d) përcaktimin e së drejtës së pronës së institucionit publik mbi veprën artistike.

16. Struktura përgjegjëse për artin dhe për kulturën ndjek dhe mbikëqyr zbatimin e kontratës së nënshkruar sipas pikës 15 të këtij kreu, deri në momentin e vendosjes së saj në hapësirën publike të miratuar për këtë qëllim.

17. Disbursimi i fondit realizohet, sipas fazave të mëposhtme:

a) 50% e shumës i parapaguhet fituesit të konkursit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës;

b) 25% e shumës i paguhet fituesit të konkursit pas marrjes në dorëzim të raportit përshkrues, dokumentacionit justifikues të aktivitetit, si dhe shpenzimeve të kryera brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve mbas parapagimit të parë, konfirmuar me:

i. kontratat e shërbimit me të tretët;

ii. faturat tatimore, të mbledhura sipas legjislacionit në fuqi;

c) 25% e shumës së mbetur pas pagesës së kryer sipas shkronjave "a" dhe "b", të kësaj pike, i paguhet fituesit të konkursit në përfundim të vendosjes përfundimtare të veprës fituese, si dhe inaugurimit të saj, duke ndjekur grafikun e realizimit të veprës dhe, në çdo rast, pasi është marrë raporti përshkrues, dokumentacioni justifikues që justifikon shpenzimet e kryera deri në atë moment.

18. Disbursimi i fondit, sipas përcaktimit të bërë në pikën 17 të këtij kreu, mbikëqyret nga struktura përgjegjëse për artin dhe kulturën.

19. Me kalimin e vlerës totale fituesit, vepra kalon në pronësi të shtetit shqiptar, ndërsa të drejtat autoriale i mbeten artistit, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat e autorit.

III. PROCEDURA E ANKIMIT ADMINISTRATIV

1. Ndaj vendimit të shkualifikimit, subjektet e interesuara kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e njoftimit të vendimit të skualifikimit.

2. Paraqitja e ankimit sipas pikës 1 të këtij kreu, pezullon procedurën për lidhjen e kontratës me subjektin/artistin që është shpallur fitues me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

3. Shqyrtimi i ankimit realizohet nga një grup pune, i ngritur me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën, brenda (dhjetë) 10 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit administrativ.

4. Grupi i punës shqyrton ankimin dhe i paraqet ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën relacionin me propozimin për:

a) rrëzimin e ankimit; ose

b) pranimin e ankimit, anulimin e procedurës së deritanishme, si dhe rifillimin e procedurës së re të konkurrimit.

5. Kundër urdhrit të ministrit, të miratuar sipas pikës 4 të këtij kreu, subjektet e interesuara kanë të drejtë të ushtrojnë ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ky ankim nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Vendimi nr. 510, datë 18.7.2012, i Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare për realizimin e veprave monumentale të artit pamor në hapësirat publike", shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**